



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI KONKURENCËS

Nr. 613/17 prot.

Tiranë, më 05.12.2022

VENDIM

Nr. 926 Datë 05.12.2022

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ILIRIKA DZU AD BEOGRAD NGA SHOQËRITË E GRUPIT OTP”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.12.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ILIRIKA DZU AD Beograd nga shoqëritë OTP Alapkezelo Zartkouden Mukodo Reszvenytarsasag dhe OTP banka Srbija.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ILIRIKA DZU AD Beograd nga shoqëritë e Grupit OTP.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ILIRIKA DZU AD Beograd nga shoqëritë OTP Alapkezelo Zartkouden Mukodo Reszvenytarsasag dhe OTP banka Srbija.

Referuar “Kontratë për shitjen e aksioneve të ILIRIKA Drustvo za upravljanje UCITS fondom AD Beograd” palët janë:

Blerësi 1: OTP Fund Management Pte.Ltd., është një shoqëri aksionare, e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit hungarez. OTP Fund Management është shoqëria lider e tregut për menaxhimin e fondeve të letrave me vlerë në Hungari. OTP Fund Management ka filiale në Rumani, Bullgari, Kroaci dhe Ukrainë.

Blerësi 2: OTP banka Srbija është një shoqëri aksionare, e regjistruar sipas legjislacionit serb, e fokusuar në risitë dhe digjitalizimin e operacioneve të saj, duke u ofruar klientëve përfitime të reja në shërbimin e digital banking, transferimin e fondeve tek individët private me e-mail dhe telefon etj. Banka ka traditë të gjatë në shërbimet e kujdestarisë dhe investimeve të kombinuara me praninë e fortë në treg, veçanërisht në industrinë e fondeve.

OTP banka Srbija dhe OTP Fund Management Pte.Ltd. janë pjesë e Grupit OTP, i cili është një nga ofruesit e shërbimeve bankare në Evropën Qendrore dhe Lindore. Grupi OTP është aktiv në tregun shqiptar nëpërmjet filialit të tij Banka OTP Albania SHA

Banka OTP Albania SHA është një shoqëri aksionare, themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Pranimi i depozitave monetare ose i fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimi i tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari te vet, dhënie huash të të gjitha llojeve duke përfshirë kredi konsumatorësh dhe kredi hipotekore, faktoring dhe financim të transaksioneve tregtare, etj.

Shitësi 1: ILIRIKA FINTRADE, financno posrednistvo, d.o.o, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit slloven, me objekt aktiviteti ofrimin e shërbimeve financiare dhe ato leasing.

Shitësi 2: ILIRIKA svetovanje, poslovno svetovanje d.o.o është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit slloven, me objekt aktiviteti ofrimin e shërbimeve financiare.

Shitësi 3: ILIRIKA borzno posredniska hisa d.d., Ljubljana është një shoqëri aksionare, e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit slloven, me objekt aktiviteti ofrimin e shërbimeve financiare.

Shoqëria Target: ILIRIKA DZU AD Beograd, shoqëri aksionare, e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit të Serbisë, pjesë e Grupit të kompanive Ilirika (Ilirika Group), e angazhuar kryesisht si shoqëri brokerimi. Ilirika Group ofron shërbime të tregimit të bursës, menaxhimin të instrumenteve financiare, shërbime nga fusha e shoqërive financiare dhe kryerjes së aktiviteteve të blerjes.

ILIRIKA DZU AD Beograd zotërohet 12.96% nga ILIRIKA FINTRADE, financno posrednistvo, d.o.o., 83.88% nga ILIRIKA svetovanje, poslovno svetovanje d.o.o., dhe 3.16% nga ILIRIKA borzno posredniska hisa d.d., Ljubljana.

ILIRIKA DZU AD Beograd nuk është prezente dhe nuk realizon të ardhura ne Shqipëri

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërive shitëse ILIRIKA FINTRADE, financno posrednistvo, d.o.o.; ILIRIKA svetovanje, poslovno svetovanje d.o.o.; ILIRIKA borzno posredniska hisa d.d., Ljubljana dhe shoqërive blerëse OTP Alapkezelő Zrtkourén Mukodo Reszvenytarsasag; OTP banka Srbija është

lidhur marrëveshja “Kontratë për shitjen e aksioneve të ILIRIKA Drustvo za upravljanje UCITS fondom AD Beograd”, në datë 12 tetor 2022.

Referuar kësaj kontrate, shitësit dëshirojnë ti shesin të gjitha aksionet e shoqërisë target, që përfaqësojnë 100% të kapitalit total të regjistruar të shoqërisë dhe blerësit dëshirojnë të blejnë të njëjtat aksione dhe në këtë mënyrë të marrin përsipër administrimin e shoqërisë target.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria target ILIRIKA DZU AD Beograd do të zotërohet 75% nga shoqëria OTP Fund Management Pte.Ltd. dhe 25% nga shoqëria OTP banka Srbija.

Sipas dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar, përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i menaxhimit të aseteve por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Menaxhimi i aseteve ka të bëjë me ofrimin e konsulencës për investime dhe shpesh dhe me vënien në zbatim të kësaj konsulence. Menaxhimi i aseteve mund të përfshijë gjithashtu krijimin dhe menaxhimin e fondeve të përbashkëta, të cilat më pas tregtohen në baza “të disponueshme” (off-the-shelf), duke përfshirë klientët me pakicë dhe ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të portofolit për investitorët institucionalë (fondet e pensione, institucionet, organizatat ndërkombëtare).

Subjektet që operojnë në tregun e menaxhimit të fondeve të investimeve në Shqipëri licencohen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe operojnë në zbatim të Ligjit nr. 10 198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe akteve të tjera të nxjerrë në zbatim të tij.

Referuar të dhënave AMF, rezulton se në tregun e kapitalit janë të licencuar 12 subjekte “Fonde Investimesh” dhe shoqëria OTP Bank Albania nuk është e licencuar në Tregun e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive dhe nuk ka pjesë tregu në menaxhimin e aseteve për tre vitet e fundit financiare.

Transaksioni i njoftuar synon përfundimin e kontrollit të shoqërisë ILIRIKA DZU AD Beograd nga shoqëritë e Grupit OTP (OTP Fund Management Pte.Ltd. dhe OTP banka Srbija). Grupi OTP është prezent dhe realizon të ardhura në Shqipëri nëpërmjet filialit të saj OTP Bank Albania SHA në tregun e shërbimeve bankare.

Shoqëria target, ILIRIKA DZU AD Beograd, operon në tregun e menaxhimit të aseteve dhe nuk vepron dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ILIRIKA DZU AD Beograd nga shoqëritë e Grupit OTP.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS


Leida MATIJA


Zv/Kryetar

Rezana KONOMI


Anëtar

Adriana BERBERI


Anëtar

Durim KRAJA


Anëtar

